

Data 25.10.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: *Ndërtim Rrugët " Josif Mihali + rrugicat(Rruga pingul me Lidhja e Prizrenit +Jusuf Gervalla) + Llazo Palluqi + Llambro Andoni + Memo Meta"*

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45233120-6

Punime ndërtimi në rrugë

Afati i realizimit të punimeve është **130 ditë pune**, sipas grafikut të punimeve. Garancia për mbulimin të defekteve ,që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë 2 vjet .

Vlera e fondit limit: **58,457,004** *(pesëdhjetë e tetë milion e katërqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katër) lekë pa tvsh.*

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Kamëz**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Lista e Çmimeve sipas Zërave Të Preventivit, **sipas** Shtojcës 2;
- c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- ç. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPPdhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas *shtojcës 8 të DST*.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit). **Shënim:** Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar. AK mund të kërkojë nga OE pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojë raportet nëpërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve, është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë: 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 5, datë: 30. 01. 2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit nr. 29, të ligjit nr. 8438, datë: 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: Çdo tatim-pagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatim-paguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabel, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.

2. Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :

- vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, bazuar në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 1, të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 dhe për vitin 2023 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kamez, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Kapaciteti teknik

Për sa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori/t Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon të paktën:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundi, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Dhe /ose

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpallje së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in si dëshmi, vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës nr. 9, të DST,
 - Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 - Situacionin përfundimtar të objektit;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Fatura tatimore.
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori/t Ekonomik duhet të paraqesë/in si dëshmi, vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, dokumentacionin e mëposhtëm:
- Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 - Situacionin përfundimtar të objektit shoqëruar me faturën;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Fatura tatimore perkatëse.
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.

1.3 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomik si dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit.

- 1.4 Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. “Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 te VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamez, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. “Njësia përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Sipas këtij neni, njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacioneve ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së nr. 285 datë: 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të kësaj VKM-je, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike, për të pasur mundësi të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktor edhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Meqenëse se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit

kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

3. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjië, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- NP - 1 A Punime gërmimi në tokë.
- NP - 4 C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- N.P – 7 A Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.
- N.P– 11 A Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- N.S – 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
 - NS - 6 A Sinjalistika rrugore jo ndricuese.
 - NS - 18 A Punime topogjeodezike.
- sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi;

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Kategoritë e licenses “N.P dhe N.S” të përcaktuara në pikën 2 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik janë hartuar në përputhje me zërat konkret të punës që përmban preventivi i punimeve. Me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për këto kategori si dhe të disponojnë nënkategoritë sipas gërmave që parashikohen nga legjislacioni përkatës. Përcaktimi i nënkategorive është vendosur nga mbledhja e vlerave të secilit volum pune, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

N.P-1A (Punime gjermimi në tokë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gjermime në tokë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P - 4 C (Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me ndertime *Punime ne rruge*, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P - 7 A Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me ndertime kullimi e vaditje ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P- 11 A Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e mesëm dhe shpërndarjen e energjisë

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me Punime të spostime shtylla ,....., ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.S - 1 A Punime për prishjen e ndertimeve

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me Punime të prishjes se ndertime si prishje muri me blloqe ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.S - 6 A Sinjalistika rrugore jodriçuese

Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune që kanë të bëjnë me sinjalistikën rrugore jo ndriçuese të cilat shtojnë të nevojshme që Operatori Ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë N.S-6A.

N.S-18 A (Punime topogjeodezike)

Duke qenë se në projekt e preventiv janë parashikuar punime të natyrës topogjeodezike dhe është e nevojshme zotërimi i kësaj pike license.

Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

4. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:
- a) Librezë pune;
 - b) Kontratë pune e vlefshme;
 - c) Diplomë.

(Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit).

Argumentimi;

5. Operatori ekonomik duhet te kete nje punesim mesatar minimumi **punonjës 48 (dyzet e tetë) punonjës** (bashke me stafin Teknik) te vertetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave dhe listpagesat perkatese të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi; Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej **48 (dyzet e tetë) punonjës** me kohe te plote, për të paktën 3 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, , ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar dhe punëtorë për punime me krahë,drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të rënda etj., duke pasur parasysh njëkohësisht volumin e lartë të punimeve.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj eshte kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Duke gene se në projekt e preventiv janë parashikuar punime të natyrës topogjeodezike dhe është e nevojshme zotërimi i kësaj pike license.

Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

6. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht
 - 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
 - 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
 - 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder
 - 1 (një) Inxhinier Elektrik

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP-1, NP-4, NS-1, NS - 12** është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS 18** është e nevojshme prezenca e një

Inxhinier Gjeodet/Topograf/, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Hidroteknik**.
- 1 (një) Inxhinier elektrik Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit elektrik**.

7. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuuar 1 (nje) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështet në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, si dhe ligjin 8402 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit" date 10.09.1998 i ndryshuar, ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", të Ligjit nr.124/2015 "Për eficientësin e energjisë".

Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. *Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes*

8. Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar në stafin 1 (një) mjek të përgjithshëm, bazuar në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë" i ndryshuar.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e individuale të punës,
- diplomën universitare.
- licencën përkatëse për ushtrimin e profesionit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në përputhje me parashikimet e VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet mjekesore për stafin e tyre, nëpërmjetë punesimit të një mjeku.

9. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, diplome leshuar nga autoritetet pergjegjese shtetore, dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

- Teknik ndërtimi 2 (dy)
- Teknik topograf 1 (një)
- Hidraulik 3 (tre)
- Elektracist 3 (tre)
- Saldator 2 (dy)
- Karpentier 2 (dy)
- Pllakashtrues 2 (dy)
- Hekurkthyes 2 (dy)
- Specialist Ndertimi per punime ne rruge dhe asfaltim 2 (dy)
- Murator 2 (dy)
- Specialist per punime betoni 2(dy)
- Eskavatorist 2 (dy)
- Automakinist 2 (dy)

10.1. Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë :

- a) Kontrata e punës, e vlefshme;
- b) të figurojë në Listpagesat e subjektit për 3 muajt e fundit.
- c) dokument (diplomë/çertifikatë e arsimit profesional) që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm, lëshuar nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH” ose ekuivalent .
- d) Certifikatë të sigurimit teknik lëshuar nga institucione të autorizuara nga R.Sh / psh ish (IQT) ose ekuivalent, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë

si dhe një deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtëm :

Nr	Emer Mbiemri	Profesioni	Data e fillimit te marredhenieve te punes	Nr. Amzes/ ekuivalent i diplomes/ ekuivalent certifikates profesionale	Institucioni/ Subjekti certifikues	Datat e vlefshmerise se certifikates se sigurimit teknik

10.2 Për punonjësit Eskavatorist/ Automakinist, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Kontrata e punës, e vlefshme;
- b) leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) (Në rastin kur punonjësit Eskavatorist / Automakinist / Buldozerist janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

10.3. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit në pikën 11, emrin/mbiemer, profilin e punës, numrin e kontratës individuale të punës, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmerise se saj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar gjithashtu duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur Autoriteti Kontraktor në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

- **Teknik ndërtimi**, të cilët janë të nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, duke pasur parasysh punime ndërtimore që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve, mur tulle për puseta, bordura betonarme etj.
- **Teknik topograf**, të cilët janë të nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, duke pasur parasysh punime topografike që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve.
- Punonjës **Hekurkthyes** janë kërkuar për të realizuar kthimet e hekurit, kornizat e hekurit në armaturat e betonit në punimet e betonit. Këta punonjës realizojnë kthimet e hekurit, kornizat e hekurit në armaturat e betonit në punimet e betonit dhe shtresë betoni. Specialistët hekurkthyes presin, përkulin dhe vendosin rrjeta teli në strukturat e betonit, bëjnë planet e punës në lidhje me strukturat e hekurit dhe betonit, përgatitin shufra çeliku ose rrjeta çeliku me gjatësinë e kërkuar duke i prerë ato me mjetet përkatëse, mbledhin shufrat ose rrjetat përforcuese duke salduar, instaluar në tokë ose prerë në vende të paracaktuara brenda betonit, fabrikojnë struktura çeliku dhe vendosja e tyre si strukturë për derdhjet e betonit, etj.
- **Specialistet karpentier** janë kërkuar për të realizuar punimet e armaturave në beton duke pasur parasysh volumin e punimeve me hekur beton (referuar preventivit). Është e nevojshme për prerjen dhe montimin e strukturave prej druri, si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet.

- **Punonjësit saldatorë** janë kërkuar për kryerjen e të gjitha punimeve që kanë të bëjnë me saldimit drejtimin bashkimin e detaleve të ndryshëm me prerjen e tyre me bashkimin e objekteve të madhësive dhe formave të ndryshme, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura sipas zërave të preventivit të punimeve. Këto përcaktime janë bërë edhe në specifikimet teknike të publikuara në SPE.
- **Hidraulikë**, të cilët siç parashtruar më lart, janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e të gjitha punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve. Konkretisht: Në specifikimet teknike, parashikohet furnizim vendosje i tubave përfshirë të gjithë mbështetësit, rakorderitë dhe mbrojtjet, pajisje shtesë për shtrimin. Cilësia e Instalimit varet në një masë të madhe nga personeli që do të bëjë këtë bashkim, dhe respektimi prej tyre i kërkesave teknike. Për këtë arsye, specialistët që do të punojnë për bashkimin e tyre, duhet të jenë të pajisur me certifikatën përkatëse për punimet hidraulike, e cila do të vërtetojë kualifikimin dhe trajnimin e tyre.
- **Specialistet elektrikist** janë kërkuar për të realizuar punimet elektike duke pasur parasysh që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve
- **Murator** janë kërkuar për të realizuar punimet e armaturave në beton duke pasur parasysh volumin e punimeve me hekur beton (referuar preventivit). Është e nevojshme për prerjen dhe montimin e strukturave prej druri, si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet.
- **Specialist për punime asfaltimi** janë kërkuar për të realizuar punimet e asfaltimit duke pasur parasysh që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve.
- **Punetoret e thjeshte**, janë kërkuar për realizimin e punimeve të thjeshta që nuk kërkojnë njohuri specialitetesh.
- **Automakinistë** me kontratat e punës (të vlefshme), dëshmi e aftësisë profesionale për përdorimin e makinerive të renda të ndërtimit dhe punimeve në tokë D.A.P (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Korrik 2023 - Shtator 2023**.
- **Ekskavatorist** me kontratat e punës (të vlefshme), dëshmi e aftësisë profesionale për përdorimin e makinerive të renda të ndërtimit dhe punimeve në tokë D.A.P (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për **Korrik 2023 - Shtator 2023**.

(Në rastin kur punonjësit Manovrator dhe dy drejtues mjetesh janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Ky kusht do të plotësohet nga operatorit Ekonomik tek formulari i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 në DST.

10. 4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

12. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015)
- b) Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.
- c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit **ISO 45001-2018**, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 45001-2018.

Argumentimi: Referuar VKM-së nr. 285, datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 44 “Kërkesat e cilësisë”, pika 1 si dhe Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 79, Autoriteti Kontraktor, ka të drejtë të kërkojë certifikata të lëshuara nga një organ i akredituar ose organizma ndërkombëtarë, me qëllim që, operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën, të jenë certifikuar në sistemet e menaxhimit të cilësisë, të mjedisit, të shëndetit dhe sigurisë në punë si dhe menaxhimin e integruar, në përputhje me objektin e kësaj kontrate dhe e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë.

Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkojë certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos punimeve që do të kryhen nga operatorët ekonomik ofertues, këto punime të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

Autoriteti Kontraktor, përpos punimeve që do të kryejë, kërkon që këto punime të zhvillojë në përputhje dhe garanci të plotë me sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve. Kjo certifikatë garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi, kryerjes së një veprimtarie apo pune publike e cila vë apo mund të vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e punonjësve.

13. Operatori ekonomik te disponojë liçense lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mjetëve jo te rrezikshme me Kodin III.2.B shoqëruar me aktin e miratimit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku

parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/B të këtij ligji”.

Në shtojcën I/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën **për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

14.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5 -10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Kamioncine me kapacitet mbajtës deri ne 3.5- 5 ton	në pronësi ose me qira	Cope 2
5	Kamioncine me kapacitet mbajtës deri ne 1.5-3.5 ton	në pronësi ose me qira	Cope 2
6	Kamioncine me kapacitet mbajtës deri ne 1.5 ton	në pronësi ose me qira	Cope 2
7	Autovinc	në pronësi ose me qira	Cope 2
8	Eskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	Cope 2
9	Eskavator me zinxhirme cekic pneumatic	në pronësi ose me qira	Cope 1
10	Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Cope 1
11	Fadroma me goma	në pronësi ose me qira	Cope 2
12	Grejder i targuar me goma	në pronësi ose me qira	Cope 2
13	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Cope 2
14	Minifadrome /bobgat	në pronësi ose me qira	Cope 2

15	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Cope 2
16	Autopompe	në pronësi ose me qira	Cope 1
17	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Cope 1
18	Autobitumatrice	në pronësi ose me qira	Cope 1
19	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Cope 1
20	Autorimorkiator mjetesh	në pronësi ose me qira	Cope 1
21	Rul ngjeshes gome-hekur jo me pak se 10 ton	në pronësi ose me qira	Cope 1
22	Rrul asfalti gome-gome	në pronësi ose me qira	Cope 1
23	Rrul i vogel deri 6 ton	në pronësi ose me qira	Cope 1
24	Rrul asfalti me kompresor gome-hekur mbi 15 ton	në pronësi ose me qira	Cope 1
25	Rrul me vibrim hekur-gome mbi 12 ton	në pronësi ose me qira	Cope 1
26	Motogjenerator / Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
27	Saldatrice / motosaldatrice	në pronësi ose me qira	Cope 1
28	Pajisje per hekurkthyes (tranxhe / elektrobango)	në pronësi ose me qira	Cope 1
29	Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	në pronësi ose me qira	Cope 1
30	Kompresor ajri	në pronësi ose me qira	Cope 1
31	Depozite uji 5000 lt	në pronësi ose me qira	Cope 2
32	Sharre asfalti	në pronësi ose me qira	Cope 1
33	Pompe uji per pastrim	në pronësi ose me qira	Cope 1
34	Tokmak per ngjeshje	në pronësi ose me qira	Cope 1
35	Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 1
36	Skarifikues asfalti	në pronësi ose me qira	Cope 1
37	Makineri vijejimi	në pronësi ose me qira	Cope 1
38	Vibrator betoni	në pronësi ose me qira	Cope 2
39	Betoniere 0.5m3	në pronësi ose me qira	Cope 2

40	Kulle Ndricimi	në pronësi ose me qira	Cope 1
41	Betoniere kantieri	në pronësi ose me qira	Cope 1
42	GPS	në pronësi ose me qira	Cope 1
43	Instrument nivelimi, Autolevelier	në pronësi ose me qira	Cope 1
44	Nivelues Betoni	në pronësi ose me qira	Cope 1
45	Pirun Ngrites	në pronësi ose me qira	Cope 1
46	Prerese pllaka betoni	në pronësi ose me qira	Cope 1
47	Set semaforesh	në pronësi ose me qira	Cope 1
48	Buldozer	në pronësi ose me qira	Cope 1
49	Dumper	në pronësi ose me qira	Cope 1
50	Makine teknologjike per pastrim puseta te ujesjelles kanalizime te zgarave te shiut veteshkarkuese me kazan te mbyllur dhe transport materialesh mbetjesh te ndryshme	në pronësi ose me qira	Cope 1

Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier"(i ndryshuar) me VKM-në nr.563, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndeti për përdorimin e paisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës", dhe VKM-në nr.564, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës" si më poshtë vijon:

- Kokore mbrojtëse minimumi **48 (dyzet e tetë)** () copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 6 (gjashtë) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 6 (gjashtë) copë
- Karroce tip karele me dy rrota me mbishkrim "Kujdes Punime në rrugë dhe me ndricim për natën".
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 30 (tridhjetë) cope.

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.
- f) çertifikatë transporti

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- a) kontrata e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);

- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.
- f) certifikatë transporti

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit dhe foto të tyre.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojta për tu kërkuar sqarime nga AK.

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit dhe foto të tyre.

Argumentimi : *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.*

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e Prokurimit